


INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

# STUDIME ALBANOLOGJIKE



7

Shkup, 2013

AFRIM A. REXHEPI

## DEKONSTRUKSIONI I IMAZHIT

*(haiku poezia dhe teoria e filozofia protonistike<sup>1</sup>)*

Ajo që intrigon pragramën logjike shkencore – mbrojtja e trurit estetik, si dhe fuqizimi i kritikës estetike përmes distinkcionit: teoria letrare dhe estetika, është perceptioni / shija dhe kuptimi ideor që rezultojnë nga objekti estetik. Sot, është e definuar pragma që shija i takon estetikës – aesthesis, ndërsa e vërteta është objekt venerues i teorisë. Shija i takon të bukurës, kurse teoria të vërtetës, edhe pse sot teoria dhe estetika janë komplementare, por jo identike. Arti është kompozim i kaosit – kaomos. *Lulet e diellit* të Van Gogut apo *Lulja që vështron* e Rodenit, janë objekte që (na) vështrojnë. Dikur Basho tha: “Mësoni si ti ndëgjoni, si gjërat flasin për vete”. Flasin për vizionet brenda objekteve, që përmes shprehjes së përjetësisë i japin jetë jetës. Sublimja e poezisë haiku, qëndron në zbulimin e realitetit në dimensionin e çudisë dhe lirisë absolute. Paradigmat e inteligjencës: racionale dhe emocionale, demonstrojnë që inteligjencia racionale nuk është entitet logjik apo racional, por identitet emocional që vibron duke mos e deformuar formën e saj të ngurtë / stabile. Përjetësisht mbetet konstantë e shpirtit apo dimension esencial i jetës, që asocion ngjyrën e kuqe që kuqëzon të Sezanit. Për Sezantin ngjyra shpreh natyrën. Piktori është më shumë se artist, sepse ai nuk percepton, por shpreh perceptet – ndjenjat kristal. Percepti ka kuptimin e shprehjes së imazhit para njeriut, shpreh mungesën e tij. Paradigmat e inteligjencës: racionale

<sup>1</sup> Protonizmi si percepton linguistik dhe si termin i adaptuar bazohet në premisat shkencore të kimisë dhe fizikës, konkretisht bazohet në termin proton, që duke qenë pjesë përbërëse e bërthamës së atomit, krijon ngarkesën elektrike pozitive +1. Protonizmi është interpretim / kritikë e objektit estetik me efekt pozitiv. Protonizmi është interpretim i hipotezës të së njohurës në kuptimin metafizik, dhe interpretim i pjesërishtëm i të njohurës në kuptimin filozofik. Qëllimi bazë i teorisë protonistike, është zbulimi dhe pranimi i realitetit objektiv tekstual në letërsi dhe arte. Pranimi realizohet përmes pesë principeve: - e vërteta tekstuale; - humajtimi; - restituitimi; - protonizmitotika dhe etika. Përmes pesë principeve, interpreti i tekstit / kritikës, është i detyruar ta pranohë kodin – ekuacionin kuadratik, me qëllim që perceptuesi ta nuhasë dhe ta zbulojë qenësinë e tekstit – protonin plus, efektin e parë të shijes së bukur / energjia spontane e materies. Në kohën e kulturës globale, kur edhe janë të deformuara të gjitha vlerat, edhe ato estetike, teoria protonistike ka vlerën e vet, sepse e ka aftësinë të hap rrugën e precizitetit të vlerave universale estetike. Teoria dhe filozofia protonistike, është hipotezë e mundësisë së përkufizimeve të komplikuar të pakufizueshmërisë, një mundësi të promovohen elementet pozitive të letërsisë, të cilat janë pjesë integrale të ligjeve natyrore universale, një mundësi e promovimit të idealeve universale të njeriut. Protonizmi kjo teori letrare e propozuar nga Gjek Marinaj Protonism: theory into Practice, është miratuar si njëra nga teoritë letrare të botë së re, në Konferencën e profesorëve të letërsisë në De Moen, Ayova, USA, të datës 23. 2. 2011.

dhe emocionale, demonstrojnë që inteligjenca racionale nuk është vetë entitet logjik apo racional, por identitet emocional që vibron / drithëron, duke mos e deformuar formën e saj të qëndrueshme: Përjetësisht mbetet konstantë e shpirtit apo dimension esencial i jetës, që asocon ngjyrën e kuqe të Sezanit e cila shpreh natyrën. Piktori është më shumë se artist, sepse ai nuk percepton por i shpreh perceptet – ndjenjat kristal. Percepti ka kuptimin e shprehjes së imazhit para njeriut, shpreh mungesën e tij.

“Dhe ja enigma, njeriu i tëri prezent dhe joprezent në vepër...Gjithçka është vështrim, kompozim. Bëhemi zero, bëhemi univers”. (Deleuze / Guattari, 2008; 210)

Ajo që i jep logjik mendimeve me lartë, është dekonstrukcioni analitik midis haiku – pezisë dhe silogjizmit, dy procese të ndryshme njohëse, dy perceptione të ndryshme (Lindje – Perëndim), e që në esencë dallohen gjatë perceptcionit të ndryshëm të realitetit. Logjika haiku nuk definon, është moment / çast i përjetësisë, ndërsa silogjizmi definon realitetin. Shembull tipik i silogjizmit deduktiv:

Analiza e realitetit:

Unë jam njeri i cili / ushqehet duke i vështruar / fushat me lule

(Basho)

Unë jam njeri: ekziston njeriu – teza; njeriu ka nevojë për ushqim – aksioma; njeriu është edhe poet, që ka nevojë për ushqim shpirtëror – sinteza. Demonstruam funksionin e silogjizmit triadik deduktiv në definimin e realitetit për ta demonstruar analogjinë midis silogjizmit dhe imazhit haiku që përmes ekuacionit trijadik zbulon enigmën, realitetin e çuditshëm.

Analiza e realitetit të çuditshëm, përmes strukturës gramatikore:

Peshkatori i mplakur / një bretkocë kërceu / tinguj uji

(Basho)

Peshkatori i mplakur: është subjekt; një bretkocë kërceu: është kallëzues; tinguj uji: është objekt. Realizimin e realitetit të çuditshëm e bën kallëzuesi, perceptcioni që është vetëdija e realitetit të tillë. Distinkcioni haiku imazhi dhe silogjizmi, bëhen funksional përmes definicionit:

“Haiku është kompozicion i shkurtër fjalësh (përdoren fjalë konkrete, në vend të nocioneve abstrakte) që zbulon ritmikën e natyrës apo dridhjet shpirtërore të njeriut dhe raportet në harmoni midis tyre”. (Tauchner, 1993; 3)

Haiku nuk është analizë e realitetit, por perceptcion / përjetim i realizuar në kuadër të ciklit natyror të stinëve, percept që shfaqet dhe zhduket shpejt, dhe përmes jukstapozicionit të shijes, zbulon çudinë - një proces i çastit në lëvizje.

Në një moment, pa përjetësinë / Në majen e një vale / Ai Hokusai!

Interpretët europian, valën e Hokusait e interpretuan si një kalim midis frikës dhe shpresës. Imazhi dhe kuptimi, bëhen një në tendencën për të shprehur atë që ekziston, një çast i çuditshëm, një çarje e përjetësisë. Fenomenologjia e perceptcionit estetik visuel gjegjësisht esencializmi i visualitetit në raport me imazhin haiku, parashtrohet pyetjen e radhës: A janë të gjitha objektet (imazhi – artistik) të madhësisë së njejtë ose të gjitha objektet kanë kuptim të njejtë?

Sigurisht që jo, sepse gjatë aktit të perceptimit të imazhit, ekziston ngjarje e

cila definohet përmes aktit vështrim (perceptim intencional). Nocioni ngjarje nuk nënkupton ngjarje visuelle si objekt (imazh), por si imazh visuel lëvizës i çastit.

"Imazhet subjektive janë rezultat i lidhjes midis ngjarjes dhe përvojës.

Visioni është sinestesik (p. sh. kur ndëgjimi i tingujve prodhon vizualizim të ngjyrave)". (Bal; 2003: 5)

Mike Bal, vlerëson idenë e distinkcionit të visualitetit që nga aspekti gjuhësor nuk është funksional, sepse nëse e izolohet visionin, nuk do të mund ta kapim objektin në plotninë e saj. Haiku është poezi visuelle, e veçanërisht kur është e stiluar me figura, estetikisht është më funksionale. Një harmoni projektive midis spontanitetit dhe vetperceptcionit e që mund të realizohet duke i vënë në funksion konstruktiv elementet teknike: formën, fenomenet referenciale të natyrës, ngjarjet dhe paraqitja e ngjarjeve në të tashmen.

"Nëse duam që haiku të definohet si formë respektabile letrare dhe estetike, duhet të depërtojmë më thellë se sa të shfaqurit e momentit...të perceptojmë dhe më shumë të shprehim iluzionin dhe fantazinë". (Gurga, 2007; 7)

Midis diksionit dhe fiksionit, haiku është fiksion / diskurs fikcional që realizohet përmes aluzionit, krahasimit, metaforës, simbolit etj. Fjala kyçe *kigo* – fjalë sezonale apo *kidai* – tema sezonale është ajo që krijon haikun edhe atë mundëson internacionalizimin e saj – mundësinë e përshtatjes së haikut në gjuhët dhe kulturat e ndryshme. Nëse haiku i krijuar i ruan elementet sezonale, koncepti fjalë kyçe e përforcon estetikën haiku edhe në gjuhët dhe kulturat tjera sepse mundëson që haiku të realizon estetikën e saj: të shohim veten dhe perceptcionin si pjesë të një tërësie, të ngritemi në efektin e perceptit. Dekonstruksioni / dallimi që lidh zbulon esencën haiku, ajo "që dikur Basho e quante kërkim pas bukurisë së vërtetë...që ndodhet në gjërat e thjeshta". Gjatë interpretimit zbulon dhe lidh dallimet / çarjet e imazhit haiku në një tërësi – imazh përmes të cilës nxiten perceptimet, emocionet, shpirti i bukur në rizbulimin e botës. Jeta mund të ndryshojë në një moment. Të kapet momenti, është estetika haiku. "Një minut i botës po kalon dhe s'do ta ruajmë dot pa u bërë dhe ne vetë minut. Nuk jemi në botë, bëhemi me botën...gjitihëka është shikim, bërje. Bëhemi univers". (Deleuze / Guattari, 2008; 211)

Çasti i përjetësisë / përjetësisht përshendetet / me mua.

(Galmic)

Haiku nuk pranon subjektin, kap momentin lëvizës, kap përjetësinë. Një art i perceptcionit, gjykimit dhe shijes estetike, një art i perceptit / ndjenjave të kulluara. Një tendencë e zgjuar dhe sensibilë pas të bukurës / e dekonstruksionit arti - jeta. Haiku demonstroi qe, "Është e dështuar thënia e Shilerit që estetika duhet ta kufizojë natyrën e lirë të ekzistencës njerëzore duke e çuar atë në dimensionin e lirisë abstrakte". (Eagleton, 1990; 106) dhe se njeriu përmes zgjuarësisë madhështore, duhet të depërtojë në objektin i cili nuk mund të jetë fatal.

Haiku poezia është imazh i duplikuar, i përbërë nga dy imazhe njëra mbi tjetrën. Më shumë imazhe dukshëm e demtojnë vlerën dhe gjykimin e pastër estetik. Haiku i vënë në konstruksion funksional përmes metrikës versifikative / theksi ritmik i rrokjeve 5-7-5 dhe zhanrit me karakteristikat thelbësore të haiku poezisë (formula haiku, ekonomia e fjalëve – kigo / fjalët sezonale, elipticiteti, sugjestiviteti,

impresioni, ekspresioni, diskursi fiksional) në vete ngërthen dy imazhe: imazhi perceptiv i autorit / intuicioni që realizohet përmes fjalëve kyçe dhe imazhi i natyrës. Në fakt, kategoria interpretative differance / dallim që lidh e Zhak Deridasë krijon poezinë haiku / simbiozën njeriu – natyra. Haiku është objektivizim i realitetit, identifikohet me natyrën - objektin.

Ndëgjoj tinguj prej shiu / Pëshpëris enigmën / të jem atje.

(Tronstromer)

Sistemi versifikativ më lartë, flet për "identitetin spekulativ", një qendër e plotësuar që logjika e dekonstruksionit e hap përmes fjalës *ndëgjoj*, duke shprehur esencën e objektit (fjalën kyçe shiu) që në fakt është esencë objektive në procesin e bërjes. Është proces që ndodh në moment. Intuitive dhe jo intelektive.

Nihilizmi i Bodrijarit, nuk flet për destruksionin e kuptimeve por për zhdukjen e tij. Tjetërsimi i njeriut të sotëm është zëvendësuar me ekstatën e objektit komunikues. Në botën e informacionit objekti është ekstatik, që në esencë është vetreferencial, i papeceptueshëm. Gjithçka ndodh në brendësinë, në imanencën e veprës, e vepra shndërrohet në shenjë, në objekt të pastër, në kristal që hakmerret.

"Loja e botës, është lojë e kthimit. Në qendër të botës nuk qëndron subjekti por fati i objektit që është fatal sepse nuk është projektion i subjektit". (Baudrillard, 1994; 14)

Në projektimin interpretativ të veprës artistike, Bodrijari nuk ra në fatalizëm të plotë. Përforcoi fenomenin e tërheqjes që ngjashëm me ikonat bizantine të cilat nuk lejojnë të parashtrahet pyetja për Zotin, ashtu edhe imazhet që dalin nga vepra artistike, tërheqin duke mos lejuar të parashtrahet pyetja për ekzistencën e saj. Është loja e tërheqjes, që për Bodrijar sundon prodhimin dhe jetën tonë. Bodrijar beson në një koncept të tillë teorik e estetik, që i gjithë arti bashkëkohor të vështrohet si akt ritualizmi, pa ndonjë funksion të gjykimit estetik. Edhe pse bota e tij është simulim, tërheqës, ekstatik, megjithatë pyetja paradigme "teoria – fiksim" mbeti pa përgjigje. Simptomat e sëmura të botës sot Bodrijar ose i zhdok ose vetë është një simptom i tillë. Totaliteti i objektit nuk qëndron, sepse në shekullin e ri arti është estetizues dhe se vepra artistike është shndërruar në objekt estetik (perceptiv) apo siç thotë Heideggeri, "Arti sot është shprehje e jetës reale", apo definimi, "Haiku është rezonance e fuqishme e shpirtit të kohës tonë". (Gilbert, 2003;1) Në funksion estetika haiku në mbrojtje të trurit estetik, shpreh imazhin e jo idenë. "Esenca e botës sot, definohet përmes përvojës estetike të jetës së përditshme". (Gurga, 2000; 6) Arti bashkëkohor është konstituencë e debatit për ontologjinë e artit (antiestetizmi i gjeneruar përmes konceptualizmit dhe neoestetizmit që shfaqet si reaksion i saj) e që kalon përmes estetikës, duke e bërë të aftë atë të reflekton ambivalencën e pafund të edukimit estetik e që nuk do të ishte e mundur të realizohet nëse do të përkufizohej vetëm në shijen estetike apo të të bukurës. Prandaj, Arti bëhet lokacion i një kritike imanente të edukimit estetik, një edukim estetik kundër një edukimi estetik. Konfrontimi i edukatës estetike apologetike dhe kritike në pragmat konkrete artistike, janë referenca bazë për shfaqjen e rolit të artistit në epokën e globalizimit dhe realizimin instrumental të saj.

Madhështia e haiku – imazhit ndodhet në rizbulimin e realitetit që lirshëm pulson në plotinë e vet. Prej të gjitha formave të poezisë, haiku posedon njëfarë raporti të veçantë ndaj realitetit, një njësi e veçantë edhe me shpirtin apsolut në kontinumin e kohës. Një fenomenolog i tipit të Huserlit, shpreh transcendencën që e definojnë në raport me objektin. Tomas Elioti në *Katër kuartetet* e tij, tregon në kohën (historike) si përbërës i aktit jashtëkohor, si një kategori universale jashtëkohore historike. Interpretimet më lart i vë në funksion konstruktiv të paradigmës estetike të Shelingut:

“Ende nuk ka ardhur koha të gjykojmë që është arritur qëllimi i hulumtimeve. Nuk mund të bëhemi rrëfyes, por interpretues të ideve të cilat janë në favorin tonë pozitiv apo negativ edhe atë duke mos dyshuar në mendimin siç edhe i kemi njohur rrënjët tona”. (Ulig, 2010; 149)

Duke e definuar si metaforë absolute, poezia haiku në kohën tonë të tjetërsuar, ka forcën e duhur t’i reciklojë ndjenjat tona për natyrën dhe të bukurën. Në analogji, protonizmi thekson disponimin pozitiv të gjendjes tonë shpirtërore në funksion të interpretimit kritik “në njohjen e të vërtetës së objekteve dhe përjetimin pozitiv të tyre ose më konkretisht pulsimin e filozofisë pragmatike të jetës – të jetohej në proporcion me ligjet universale të natyrës. Piktori i artit perëndimor, pikturon lulen në vazo, të këputur nga dega, kurse piktori i artit lindor, pikturon lulen të lidhur me degën, ashtu siç është në natyrë duke e shprehur vizualisht tërësinë harmonike – ritmikën e natyrës.

Nëse haiku – poezia është botë e përjetimit poetik të jetës, protonizmi është prigmë interpretative në përforcimin e forcës perceptive në kohën e shoqërive të konsumuara, në të cilat liria e krijuar në perceptimin e veprave artistike, do të ishte ekuivalente me lirinë në realitetin fizik. Një tendencë në favor të estetikës analitike. Protonizmi si teori dhe filozofi pragmatike është funksionale në raport me hapjen kah përjetësia, sikur pragma filozofike e Simon Vejit, “E ndjejmë të keqen në ne, i frikemi asaj dhe duam shumë të lirohemi nga energjia negative. E keqja është në ne, e kërditshmja është në ne”. (Svendsen, 2010; 182) Kemi nevojë për abjekcion përmes artit do të thoshte Julia Kristeva. Protonizmi (teorik dhe filozofik) i Gjeke Marinajt, ndodhet në anën pozitive të binomit: bota siç është (-) dhe bota siç duhet të jetë (+), duke kështu e përforcuar idenë e ndryshimit të botës nga burimi, nga geneza.

#### Literaturë e konsultuar:

- Arnason, H. H. (2003), *History of Modern Art*, Prentice Hall, New York.
- Bal, Mieke: (2003), *Visual essentialism and object of visual culture*, Journal of Visual Culture, London.
- Marinaj, Gjekë: (2011) *Protonizmi: Nga teoria Në praktikë – vizione letrare*, Tiranë.
- Бодријар, Жан: (2001), *Симулакруми и симулацији*, Скопје.
- Deleuze, Gilles / Guattari, Felix: (2008), *Ç’është filozofia*, Zenit art, Tiranë.
- Eagleton, Terry: (1990), *Schiller and Hegemony*, The Ideology of the Aesthetics, Blackwell Publishers, London.
- Gurga, Lec: (2000), *Modern Haiku*, vol. nr. 3, Ylinois.

- Gilbert, Richard: (2003), *Global haiku and the Work of Jim Kacian*, London.
- Hackett, James W: (2005), *Haiku spirit – suggestions to write haiku*, [www.haikuspirit.org](http://www.haikuspirit.org)
- Петровиќ, Сретен: (2006), *Деконструкција естетике*, Бања Лука.
- Tauchner, Dietmar: (1999), *X – Plain*, red. Cor Van Den Huvel, Norton.
- Ulig, Klaus: (2010), *Teorija književne istorije – nacela paradigma*, Zagreb.
- Ларс Свендсен: (2010), *Филозофија на злато*, Скопје,